Transportin kallashnikov për t'i shitur në Sarandë, arrestohen dy të rinj (emrat)

31 Mars, 2024 11:58

Madhësia e tekstit:

Dy persona përfunduan në prangat e policisë së Sarandës pasi transportonin armë automatike kallashnikov. Operacioni i koduar "Strike 8", duke prangosur shtetasit Eduart Musej. 34 vjeç si dhe Evidoned Shahini, 31 vjeç.

Njoftimi:

Sarandë/Vijojnë puna e inteligjencës policore dhe kontrollet intensive të shërbimeve, për të garantuar sundimin e ligjit në territor.

Finalizohet nga Komisariati i Policisë Sarandë, operacioni policor i koduar "Strike 8", për goditjen e një rasti të tentativës për të shitur armë zjarri.

U kap në flagrancë me armë zjarri kallashnikov, të cilën dyshohet se do ta shiste në qytetin e Sarandës, vihet në pranga 34-vjeçari.

Vihet në pranga dhe një 31-vjeçar, i cili dyshohet se do të ndihmonte 34-vjeçarin, për të shitur armën.

Sekuestrohen arma e zjarrit kallashnikov, 1 krehër me municion luftarak dhe 2 automjetet e këtyre shtetasve.

Shërbimet e Komisariatit të Policisë Sarandë, në zbatim të masave të përcaktuara në planin operacional mbarëkombëtar "Sundimi i ligjit", për parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale në fushën e mbajtjes pa leje të armëve, kanë organizuar dhe finalizuar operacionin policor të koduar "Strike 8".

Sponsored Links

Si rezultat i këtij operacioni, u kapën në flagrancë, në vende të ndryshme, në fshatin Berdenesh, dhe u vunë në pranga shtetasit:

E. M., 34 vjeç, banues në Sarandë, pasi gjatë kontrollit në automjetin tip "Audi", që ai drejtonte, shërbimet e Policisë gjetën 1 armë zjarri kallashnikov dhe 1 krehër me municion luftarak, të cilat dyshohet se ky shtetas do t'i shiste në qytetin e Sarandës;

E. Sh., 31 vjeç, banues në Sarandë, pasi nga veprimet hetimore dyshohet se do të ndihmonte shtetasin E. M., për të shitur armën e zjarrit. Ky shtetas është kapur nga shërbimet e Policisë ndërkohë që drejtonte një automjet tip "Ford".

Arma e zjarrit kallashnikov, 1 krehër me municion luftarak dhe 2 automjetet e shtetasve të arrestuar, u sekuestruan në cilësinë e provës materiale.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, për veprime të mëtejshme.

Për t'u bërë pjesë e grupit '**Balkanweb**' mjafton të klikoni: Join Group dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. Grupi Balkanweb

TË NGJASHME
Ad

Sulmuesi bardhezi më në fund shënohet me grupin, Juventus nis përgatitjet për Lazion
31 Mars, 2024

Aksident në Bruksel/ Autobusi me turistë përplaset me pemën, raportohet për pesë të plagosur, tre në gjendje të rëndë
31 Mars, 2024

TaboolaFeed

Nën akuzë nga SPAK/ Kush është Deborah Keçi, drejtoresha që 'reklamon' jetë luksi në rrjetet sociale (foto)
balkanweb.com


Arrestohet ish-gruaja e Mirit të Xhikes, në 2012 u la e lirë
balkanweb.com



Gjashtë banorë në televotim, ja kush u largua nga shtëpia e Big Brother. Kë parashikon fitues
balkanweb.com

Vrasja në banjë zbardhet pas 26 vjetësh. Bashkëshorti zbulon sekretin e burrit dhe pas divorcit e denoncon
balkanweb.com

TË FUNDIT NGA -KRONIKË

Zjarri në Fier/ Flakët u përhapën në ullishta, policia shoqëron pronarët e tokës
31 Mars, 2024

I vuri zjarrin koshave të mbeturinave, arrestohet 24-vjeçari në Gjirokastër
31 Mars, 2024

"Të qeshurat e juristëve dëgjohen deri te recepsioni"/ Zbardhen përgjimet për dosjen 5D dhe pazaret për tendera mëdis ish-drejtorëve të Bashkisë
31 Mars, 2024

Qarkullonte me armë zjarri dhe drejtonte mjetin në gjendje të dehur, arrestohet 39-vjeçari
31 Mars, 2024

U vetëdorëzua pak ditë më parë, Gjykata e Sarandës cakton masën e sigurisë për ish-drejtorin e ALUIZNI-t
31 Mars, 2024

Kaos në Rinas me sistemin TIMS? Reagon Policia e Shtetit: Ka fluks në ritëm në hyrje, por...
31 Mars, 2024

KATEGORIA VIDEO

VIDEO/ Daku mesazh Sylvinhos nga Rusia, sulmuesi kuqezi gjen golin me Rubin Kazan
31 Mars, 2024

Riaktivizohet vatra e zjarrit, përfshihen nga flakët kodrat e Peshtanit në Fier, zjarrfikësit në terren
Marsela Topi | 31 Mars, 2024

Pikat e kalimit kufitar me Greqinë mbyllen për dy ditë. Çfarë do të ndodhë me udhëtarët
31 Mars, 2024

Rrëfimi ndryshe i Elizabeta Imeraj, ish-prokurorja e dosjeve të bujshme: Ja kërshilla që u jap fëmijëve, prindërit u prekën për...
31 Mars, 2024

Mbani në kontroll kolesterolin, shmangni ndërhyrjet në zemër!
31 Mars, 2024

Video/ 'Të dua shumë Nicola', Victoria Beckham kërcen me nusen e saj në Instagram
31 Mars, 2024

BW
Download on the App Store
GET IT ON Google Play

Kërko këtu

LAJMET E FUNDIT

VIDEO/ Daku mesazh Sylvinhos nga Rusia, sulmuesi kuqezi gjen golin me Rubin Kazan
31 Mars, 2024

Riaktivizohet vatra e zjarrit, përfshihen nga flakët kodrat e Peshtanit në Fier, zjarrfikësit në terren
Marsela Topi | 31 Mars, 2024

Pikat e kalimit kufitar me Greqinë mbyllen për dy ditë. Çfarë do të ndodhë me udhëtarët
31 Mars, 2024

Rrëfimi ndryshe i Elizabeta Imeraj, ish-prokurorja e dosjeve të bujshme: Ja kërshilla që u jap fëmijëve, prindërit u prekën për...
31 Mars, 2024

Mbani në kontroll kolesterolin, shmangni ndërhyrjet në zemër!
31 Mars, 2024

Video/ 'Të dua shumë Nicola', Victoria Beckham kërcen me nusen e saj në Instagram
31 Mars, 2024

NA NDIQNI NË RRJETET SOCIALE

@balkanweb

© 2024 BalkanWeb. Të gjitha të drejtat e rezervuara.